



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivered	19.12.2022	2	viti god year
Organ /Mjesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHACK	8217/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.972/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me shenjë A.nr.972/2022 të datës 04.11.2022, të parashtruar nga ankuesja _____ me adresë banimi në _____

_____ organit të punësimit Komunes së Kamenicës, në çështjen juridike *shkelje e të drejtës në pagë*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 19.12.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.972/2022 e datës 04.11.2022 e parashtruar nga ankuesja _____.
- II. Obligohet Kryetari i Komunes së Kamenicës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunës civilë _____ nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja _____, e punësuar në Komunën e Kamenicës, më datë 04.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6701/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e ankueses për harmonizim të koeficientit të nga shtatë pikë pesë (7.5) në nëntë pikë pesë (9.5).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Kamenicës, ndërsa më datë 18.11.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6701/2022 të datës 04.11.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër protokollit 31183 të datës 28.09.2022 të parashtruar nga ankuesja të Kryetari i Komunës Akt Emërimin me numër protokollit 8014 të datës 20.03.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6896/2022 të datës 08.11.2022; Përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 7226/2022 të datës 18.11.2022; Vendimin me numër të protokollit 4787/2022 të datës 18.08.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 04.03.2021; Listën e pagave për periudhën kohore 01.09.2022 deri me datën 30.09.2022; Listën e pagave për periudhën kohore 01.10.2022 deri me datën 31.10.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile; Kërkesën me numër31183 të datës 28.09.2022; Akt Emërimin me numër 25142 të datës 05.06.2017 për pozitën e punës Udhëheqës i Prokurimit; Akt Emërimin me numër 37811 të datës 08.09.2017 për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave; e-malin e datës 04.10.2022 me numër të protokollit 6264/2022 të drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës; e-malin e datës 03.10.2022 nga KPMSHCK-ja drejtuar ; e-malin e datës 20.09.2022 të drejtuar KPMSHCK-së; e-malin e datës 19.09.2022 të drejtuar ; Shkresën me numër protkollit 6030 tw datës 27.11.2014 l nga Drejtori i DASHC-sw 8 DASHC/MAP-04/1571).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është pjesërisht e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton së ankuesja është e punësuar në Komunën e Kamenicës, rrjedhimisht e njëjta sipas Akt-it të Emërimin të datës 20.03.2020 ushtron pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit për Gjendjen Civile", me koeficient shtatë pikë pesë (7.5) të pagës. Ankuesja me datë 28.09.2022 ka parashtruar kërkesë të Kryetari i Komunës së Kamenicës për rregullimin e koeficientit të pagës me titullin e punës, e për të cilën kërkesë ankuesja nuk kishte marrë përgjigje.

Për shkak të heshtjes administrative në kërkesën e datës 28.09.2022, ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duke pretenduar që ti njihet e drejta për harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e vendit të punës respektivisht që ti behët harmonizimi i pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në nëntë (9.5).

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 33 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: "Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme

me të; dhe 2.4. *Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë*", ndërlidhur me këtë, neni 12 i Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ë ka përcaktuar se: "*Drejtues i Ulët kategorizohet Udhëheqës i Divizionit në një Agjenci Ekzekutive; 2. Udhëheqës i Sektorit në një Komunë*", andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rrjedhë së pozita *Udhëheqës i Sektorit për Gjendjen Civil*, hyn në kategorinë drejtues i ulët 2.

Në kuptim të parimit *pagë e njëjtë për punë të njëjtë* i përcaktuar me nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, Këshilli më datë 19.09.2022 dhe 03.10.2022 i është drejtuar me shkresë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë dhe funksionarëve publikë, duke kërkuar informacione në lidhje me koeficientin e pagës për titullin e punës *Udhëheqës të Sektorit*, ndërsa kjo e fundit duke u përgjigjur në kërkesë, më datë 04.10.2022 ka njoftuar se në bazë të Shtojcës Nr.1/7 të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kjo pozitë sipas katalogut të vendeve të punës është përcaktuar pozite e nivelit Drejtues i Ulët 2 me koeficienti të pagës tetë pikë pesë (8.5).

Kolegji i Këshillit, po ashtu, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka analizuar edhe provat tjera materiale të lëndës, respektivisht shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 27.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil/MAP, përmes të cilës shkresë DASHC-ja kishte kërkuar nga udhëheqësit e organizatave buxhetore që të harmonizohet koeficienti i pagës për disa pozita të punës, ku ndër të tjera është kërkuar që koeficienti i pagës për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit* të vendoset koeficienti i pagës tetë pikë pesë (8.5).

Andaj, nisur nga konstatimi se ankuesja mban pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Gjendjen Civile*, e për të cilat pozitë organi përgjegjës për administrimin e Shërbimit Civil (DASHC) kishte vendosur koeficientin e pagës tetë pikë pesë (8.5), dhe në kuptim të dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil.* 2. *Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, Kolegji i Këshillit konstaton së në këtë çështje administrative janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e pjesërishëm të ankesës së ankueses duke i dhënë të drejtë ankueses për rregullimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5), në tetë pikë pesë (8.5), për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile*. Ndërsa pretendimi ankimor i ankueses për vendosjen e koeficientit të pagës nëntë pikë pesë (9.5) nuk ka mbështetje në aktet ligjore dhe nënligjore me të cilat rregullohet çështja e pagave të zyrtarëve publikë, ashtu sikurse nuk ka mbështetje as në politikat e nënshkruara nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, si organ përgjegjës për administrimin e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës.

Përmbledhur si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.972/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

[Signature]
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.